



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVA – PREDSIEDNIK

Duke u bazuar në nenin 84 pikat 4 dhe 29 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në Ligjin për Faljen dhe Kodin Penal të Republikës së Kosovës, Presidentja e Republikës së Kosovës nxjerr këtë:

DEKRET

PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR FALJEN E PERSONAVE TË DËNUAR

Neni 1

Qëllimi

Ky dekret përcakton kriteret dhe procedurat për faljen e personave të dënuar.

Neni 2

Kriteret për falje

2.1 Falja, në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Faljen, është e drejtë e Presidentes së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidentja) dhe ka për qëllim për t'i shpërblyer sjelljet dhe karakteret e jashtëzakonshme ose t'i adresojë shqetësimet e serioze humanitare.

2.2 Në pajtim me Ligjin për Faljen, rrethanat që shqyrtohen gjatë marrjes së vendimit për falje përfshijnë:

- a. peshën e krimit;
- b. pendimin e singertë;
- c. shfaqjen e sjelljeve dhe karakterit të respektueshëm;
- d. respektimin e rregullave për socializim dhe riintegrim;
- e. ndikimin e faljes te pala e dëmtuar;

- f. arsyen specifike humanitare për falje;
- g. kohë e kaluar në vuajtjen e dënimit;
- h. rrezikun e recidivizmit dhe recidivizmin;
- i. përmbushjen e kërkesave të shërbimit korrektues;

2.3 Në shqyrtimin e kërkesave për falje, kujdes i veçantë do t'i kushtohet procedimit të rasteve për veprat me rrezikshmëri të madhe shoqërore sikurse: vrasje e rëndë e kryer me mizori, vrasje e shumëfishtë, kundër fëmijës, gruas shtatzënë, marrëdhënie seksuale me dhunë me të mitur.

2.4. Të gjitha kriteret për falje duhet të plotësohen konkretisht dhe në mënyrë kumulative.

Neni 3 Të dhënat për faljen

Kërkesës për falje duhet t'i bashkëngjiten të dhënat vijuese të të dënuarit:

1. të dhënat personale për të dënuarin/en;
2. kopja e aktgjykimit të plotëfuqishëm të gjykatës ose kopja e dispozitivit të aktgjykimit;
3. të dhënat për punën dhe arsimimin e të dënuarit/es;
4. të dhënat për gjendjen familjare (numri i fëmijëve të mitur, obligimet për mbajtje, etj);
5. të dhënat për ekzekutimin e dënimit (vendi i mbajtjes së dënimit, afatet kohore për fillimin e mbajtjes së dënimit), përfshirë të dhënat mbi lirimin me kusht;
6. të dhënat për zvogëlimin ose ndërrimin e dënimit (me zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ose me falje);
7. të dhënat nëse është paraqitur dhe realizuar kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit;
8. të dhënat për dënimet e mëparshme (lloji i veprës penale, lloji dhe lartësia e dënimit, përfshirë vuajtjen e dënimit);
9. të dhënat për kompensimin e dëmit të shkaktuar me veprën penale;
10. të dhënat për vlerësimin profesional të cilësive personale të të dënuarit, përfshirë vlerësimin për prirjet për recidivizëm dhe efektin e dënimit tek i dënuari;
11. të dhënat për sjelljen e të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit;

Neni 4 Mbledhja e të dhënave

Në bazë të kërkesës zyrtare të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës (në tekstin

e mëtejme "Zyra"), të dhënat nga neni 3 (tre) i këtij dekreti i mbledh Ministria kompetente për çështje të drejtësisë.

Neni 5

Procedura e aplikimit për falje

- 5.1 Forma e kërkesës për aplikim për falje përcaktohet nga Zyra.
- 5.2 Forma e kërkesës për falje do të jetë në dispozicion në web faqen e Zyrës, në Zyrë si dhe në institucionet e shërbimit korrektues.
- 5.3. Kërkesa për falje i drejtohet Presidentes.
- 5.4 Kërkesa për falje dorëzohet drejtëpërdrejtë në Zyrë ose përmes institucionit korrektues ku i dënuari është duke mbajtur dënimin.

Neni 6

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për falje

- 6.1 Presidentja e Republikës me vendim formon Komisionin *ad hoc* për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për falje (në tekstin e mëtejme "Komisioni").
- 6.2 Komisioni përbëhet nga së paku 5 (pesë) anëtarë dhe në përbërjen e tij do të ketë përfaqësues nga Zyra (përfshirë Departamentin për Çështje Ligjore), përfaqësues të komunitetit akademik nga lëmia e Drejtësisë dhe shoqërisë civile, si dhe përfaqësues të gjyqësorit.
- 6.3 Puna e Komisionit mbështetet nga Sekretari i Zyrës.
- 6.4 Përbërja dhe puna e Komisionit është konfidenciale. Përbërja, procedurat dhe vlerësimi i Komisionit lidhur me kërkesat për falje do të bëhen publike vetëm pas shpalljes së dekretit të Presidentes për falje.

Neni 7

Shqyrtimi i kërkesës për falje

- 7.1 Zyra përgatitë listën e kërkesve për falje së bashku me dokumentacionin e mbledhur në pajtim me nenin 3 të këtij Dekreti dhe i vënë në dispozicion të Komisionit për shqyrtim dhe vlerësim.

7.2 Pas emërimit nga Presidentja, Komisioni mblidhet në takim të veçantë për të caktuar agjendën e punës për shqyrtimin e kërkesave për falje.

7.3 Puna e Komisionit mbështetet në dokumentacionin zyrtar të siguruar në përputhje me Ligjin për Faljen dhe këtë dekret. Komisioni mund të kërkoj të dhëna shtesë nëse kjo konsiderohet e domosdoshme për shqyrtimin e kërkesës për falje.

7.4 Komisioni shqyrton dhe vlerëson kërkesat për falje në pajtim me Ligjin për Faljen dhe këtë Dekret.

7.5 Komisioni për falje harton raport me shkrim lidhur me shqyrtimin e kërkesës për Falje dhe i dorëzon Presidentes propozimin e arsyetuar.

Neni 8
Hyrja në fuqi

8.1 Me hyrjen në fuqi të këtij Dekreti shfuqizohet Dekreti Nr. DF-001-2009.

8.2 Ky Dekret hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Presidentja e Republikës së Kosovës.

Nr. i Dekretit DF-001-2012

Prishtinë, më 13 janar 2012



Atifete Jahjaga
Presidentë e Republikës së Kosovës